



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të dëgjimit të përgjithshëm publik, mbajtur më 27.08.2019, duke filluar në orën 14:00.

Të pranishëm ishin: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Diellza Begolli, këshilltare e kryetarit.

Morën pjesë edhe: Musli Gashi, drejtor i shkollës fillore “Avni Rustemi”, fshati Mramor, Bekë Mulaj, drejtor i shkollës së mesme bujqësore “Abdyl Frashëri”, Prishtinë, Fehmi Zeqiri, drejtori i shkollës fillore “Andon Zako Çajupi”, Bardhosh, Fatlum Osmani, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit, dhe Flora Rusinovci.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit.

Musli Gashi, drejtor i shkollës fillore “Avni Rustemi” në fshatin Mramor, parashtrori tri kërkesa:

1. Të bëhet ndërrimi i dritareve në shkollën amë të fshatit Mramor, pasi që ato janë shumë të vjetra dhe janë të mbyllura me gozhda;
2. Të shikohet mundësia për shpimin e puseve për sigurimin e ujit;
3. Të bëhet rregullimi i oborrit në paralelen e ndarë të shkollës në lagjen “Halitaj”.

Po ashtu, kërkoi që në këtë fshat të shihet mundësia për hapjen e një çerdheje publike. **Shpresa Shala**, drejtoreshë, tha se çështja e ndërrimit të dritareve për këtë vit nuk është në plan. Këtë projekt e kemi parasysh dhe do ta parashohim vitin e ardhshëm. Sa i përket hapjes së puseve, kjo çështje është në përfundim e sipër dhe për këtë duhet të bisedojmë edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se çështja e puseve është për hapësirat e gjelbëruara, por do të shihet mundësia që në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, të merret parasysh edhe hapja e puseve për nevoja të shkollave.

Osman Bllaca tha se politikë e Kryetarit është hapja e çerdheve me bazë dhe komunitet. Ai tha se nuk na lejohet me bërë shtimin e numrit të çerdheve publike dhe private.

Diellza Begolli, tha se në të gjitha kopshtet me bazë dhe komunitet, synimi i Kryetarit është që pagesa të jetë një shumë e përbalueshme për qytetarët e komunës së Prishtinës dhe, varësisht nga të ardhurat mujore, pagesat bëhen në bazë të përqindjeve të parapara. Fëmijët jetim, rastet sociale dhe fëmijët me një prind vetushqyes lirohen nga pagesa.

Fehmi Zeqiri, drejtor, tha se shqetësuese dhe urgjente për në është tuneli, që e kemi afër shkollës dhe nuk kalon vit pa ndonjë fatkeqësi. Do të ishte mirë që të vendoset ndonjë pengesë dhe të jetë në funksion ndriçimi, sepse nxënësit e ndërrimit të pasdites e kanë shumë të vështirë kalimin nëpër atë tunel.

Fusha sportive ka filluar me u vjetërsuar, pusetat në oborrin e shkollës janë të hapura dhe paraqesin rrezik për nxënësit. Po ashtu, mungon izolimi i tavanit të shkollës dhe kur ka të reshura, ai vazhdimisht pikon. Edhe banjat e shkollës janë në gjendje të mjerueshme dhe kundërmojnë.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se nëse është e nevojshme mirëmbajta e instalimit në tunel, mundemi me intervenuar, por nëse është i nevojshëm instalim i ri, atëherë duhet ta presim kontratën që do të nënshkruhet. Sa i përket pusetave të ujërave të zeza, përgjegjëse për rregullimin e tyre është kompania e ujësjellësit rajonal "Prishtina", ndërsa pusetat e ujërave atmosferike ne i kemi rregulluar.

Fatlum Osmani, zyrtar, tha se primare për intervenim janë kulmi dhe rrjeta e fushës së lojërave, të cilat do të rregullohen, si dhe banjat e shkollës.

Bekë Mulaj drejtor, tha se kërkesat që kanë të bëjnë me vlerën deri në 100 euro, i nënshtrohen një procedure të stërzgjatur dhe është ngarkesë shumë e madhe për ne, andaj kërkoj nga ju që të behet kjo ashtu si ka qenë përpara. Po ashtu, ceku edhe laboratorin, që është bërë inaugurimi i tij qe 2 vite e dy muaj dhe ende nuk është bërë asgjë, nuk funksionon ende. Salla e edukatës fizike është e viteve të 60-ta dhe i ka dritaret e dëmtuara shumë, ku hyn të ftohti.

Shpresa Shala, drejtoreshë, tha se kemi biseduar edhe me Drejtorinë e Financave që duhet ta gjejmë një mesatare, në mënyrë që ju ta keni buxhetin, pa pasur nevojë me bërë kërkesën në Drejtori.

Valbona Makolli, drejtoreshë, tha se sa i përket çështjeve financiare, është e mjerueshme gjendja nëpër shkolla. Ne duhet ta bëjmë një plan të veprimit për këto kërkesa, sipas numrit të kërkesave, sidomos në pjesët rurale me funksionuar. Kemi vërejtje edhe nga auditori për këto kërkesa.

Flora Rusinovci: theksoi se pagesat që i bëjnë nxënësit me rastin e thyerjes se ndonjë inventari të shkollës, si p.sh. bankave etj., ne i marrim paratë nga nxënësit dhe i dorëzojmë te drejtori i shkollës, por më pas ku mbesin ato para?

Shpresa Shala, drejtoreshë, tha se ato para shpenzohen për blerjen e bankës, mirëpo më mirë do të ishte që banka shkolllore të blihet nga vetë prindërit.

Dëgjimi publik përfundoi në orën 14:45.